




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR,
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT



10:30

20922
Nr. Prot.

611
Tiranë, më/.../2020

Lënda: Mbi monitorimin e cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Kolegjit të
Posaçëm të Apelimit

KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ngarkon Ministrin e Financave dhe Ekonomisë për monitorimin e cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm (KB) në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për të cilën raporton çdo vit në Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë.

Monitorimi i cilësisë së sistemit të KB në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është realizuar duke u bazuar në monitorimin e kryer direkt nga Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar, Kontrollin dhe Kontabilitetin (DH/MFKK), mbështetur në metodologjinë e Vizitave në Terren dhe në raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të KB të paraqitur në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 232, datë 27.02.2019.

Gjithashtu është realizuar vlerësimi i performancës së sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) në mbështetje të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 117, datë 01.04.2019, "Për Metodologjinë e Monitorimit të Performancës së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësive Publike", ku janë përcaktuar treguesit e performancës dhe mënyra e vlerësimit të tyre. Në këtë analizë përfshihen treguesit e performancës për planifikimin, zbatimin dhe ekzekutimin e buxhetit dhe treguesit për implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e të cilave bëhet rankimi i institucioneve.

Në përfundim të këtij procesi, për vitin 2019, ju informojmë se Kolegji i Posaçëm të Apelimit renditet në vendin e 16-të, midis institucioneve të pavarura, me 40 pikë nga 68 pikë maksimale të mundshme. Për informacion, Raportin Vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2019, e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (www.financa.gov.al).

Nga kontrolli në vend, evidentohet se rreth 90% e përgjigjeve të dhëna në pyetësor janë të besueshme. Ky institucion ka një shkallë të lartë ndërgjegjësimi mbi përgjegjshmërinë për implementimin e kërkesave të kontrollit të brendshëm brenda institucionit. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

1. Rregullat bazë për funksionimin e institucionit janë përshkruar në dokumentin e Rregullores së Brendshme, e rishikuar për vitin 2019;
2. Janë hartuar planet vjetore të punës për vitin 2019, me objektiva dhe aktivitete të specifikuara;

3. Ekzistojnë përshkrimet e punës për çdo punonjës si edhe kryhen vlerësimet periodike;
4. Regjistri i Riskut është përgatitur nga çdo drejtori;
5. Është ndërtuar dhe miratuar Strategjia për Menaxhimin e Riskut;
6. Është hartuar plani i trajnimeve për vitin 2019 dhe plani vjetor i punës për vitin 2019;
7. Delegimi i funksioneve realizohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas ligjit të mfk.
8. Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Grupi i Menaxhimit të Riskut është ngritur me urdhër të brendshëm të titullarit dhe ka diskutuar cwshtje qw lidhen me MFK
9. Për Grupin e Menaxhimit Strategjik ka evidencë që të jenë diskutuar çështje të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
10. Koordinator i riskut është deleguar sipas kërkesave ligjore;
11. Janë ndërtuar harta dhe manuale të proceseve të punës të miratura;
12. Janë ndërtuar Gjurmë Auditimi;
13. Rregullat e etikës janë të përcaktuara në Kodin e Etikës;
14. Respektohen procedurat ligjore të rekrutimit;
15. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”;
16. Komunikimi i informacionit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe nëpërmjet emaileve.

Duke patur parasysh stadin aktual të sistemit të KB të raportuar nga institucioni Juaj, monitorimin e kryer nga DH/MFKK pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe kompleksitetin e kërkesave ligjore për përmirësimin e tij, lutem gjeni më poshtë rekomandimet në lidhje me zhvillimet për të ardhmen të fokusuara në aspekte që lidhen me të gjithë komponentët e KB.

Rekomandimet:

1. Të rishikohet regjistri i riskut për ndryshimet në vijimësi;
2. Të mbahet vazhdimisht në konsideratë mundësia e rishikimit të manualeve të punës në bazë të ndryshimeve në vijimësi;
3. Të ndërtohen gjurmët e auditimit për proceset kryesore të punës jo vetëm për procese buxhetore dhe të prokurimeve;
4. Të hartohen baza rregullative në lidhje me raportet e përhershme, standarde që duhet ti raportohen drejtuesit si dhe menaxherëve të tjerë të strukturave të institucionit. Kjo bazë rregullative duhet të përmbajë formatet, mënyrën e raportimit, periodicitetin e raportimit, treguesit e performancës, si dhe mënyrën se si informacioni duhet të shpërndahet në të gjitha nivelet e njësisë;
5. Të ndiqet zbatimi i planit të veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së dhe ti raportohet zbatimi i tij, Nëpunësit Autorizes në mënyrë periodike;
6. Nëpunësi Autorizues mund të monitoroj sistemin e kontrollit të brendshëm duke përdorur metodologjinë e monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 117, datë 01.04.2019.

Për sa më sipër institucioni duhet të evidentojë masat e ndërmara për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga DHMFKK, në planin e veprimit të institucionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i cili duhet të dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë së bashku me pyetësin e vetëvlerësimit, deklaratën dhe raportin vjetor të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatimi i të cilave do të monitorohet në vazhdimësi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në përfundim theksojmë se në përmirësimin e punës do të gjeni mbështetjen e plotë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ku nëpërmjet asistencës dhe trajnimeve do të sigurohet kualifikimi i stafit tuaj në fushën e menaxhimit të financave publike.

Me respekt,

MINISTËR

Anila Denaj

